


ARTI ISLAM NË PERIODIKËT E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS (1945–1990)

ISLAMIC ART IN THE PERIODICALS OF THE ISLAMIC COMMUNITY OF KOSOVO (1945–1990)

Bashkim MEHANI

The Islamic Community of the Republic of Kosovo, Kosovo

 <https://orcid.org/0009-0006-0723-8478>

Abstrakt: Revistat “Dituria Islame”, “Takvimi” dhe “Edukata Islame”, së bashku formësojnë bazën periodike të Bashkësisë Islame të Kosovës. Këto botime kanë ndërtuar një trashëgimi të pasur kulturore, fetare dhe edukative, të cilat në mes shumë fushave islame, janë munduar të pasqyrojnë me besnikëri edhe vlerat etike dhe estetike të traditës islame dhe artit islam.

“Dituria Islame” ka dhënë një kontribut të veçantë në trajtimin e thelluar të artit islam, duke u përqendruar në disiplina të ndryshme si arkitektura, kaligrafia, ornamenta dhe miniatura. Artikujt e saj ofrojnë analiza të hollësishme mbi realizimet artistike dhe teorike, duke nxjerrë në pah ndikimet kulturore dhe historike që kanë formësuar këtë identitet artistik.

Ndërkohë, “Takvimi”, si botimi më i hershëm dhe që vazhdon ende sot me të njëjtin mision, e pasuron këtë traditë, duke ofruar një qasje më të thellë historike në trajtimin e artit islam dhe zhvillimeve përkatëse në hapësirën shqiptare.

Nga ana tjetër, “Edukata Islame” fokusohet në aspektin edukativ, duke ofruar studime të thelluara mbi vlerat fetare dhe kulturore të artit islam. Përmes temave që trajtojnë monumentet islame brenda dhe jashtë Kosovës, si dhe përmes ilustrimeve kaligrafike dhe ornamentale, kjo revistë promovon rëndësinë e artit islam në formimin e identitetit dhe edukimit fetar.

Së bashku, këto tre revista krijojnë një platformë të fuqishme që mbështet identitetin kulturo-fetar të komunitetit, duke ndërthurur artin, kulturën dhe historinë islame në një narrativë të përbashkët që ndriçon rrugën drejt një të ardhmeje më të pasur kulturore dhe shpirtërore.

Fjalët kyçe: Arti islam, Dituria Islame, Takvimi, Edukata Islame, kaligrafia

Abstract: The journals “Dituria Islame,” “Takvimi,” and “Edukata Islame” together constitute the periodical foundation of the Islamic Community of Kosovo. These publications have built a rich cultural, religious, and educational legacy and, across many Islamic fields, have sought to faithfully reflect the ethical and aesthetic values of Islamic tradition and Islamic art.

“Dituria Islame” has made a distinctive contribution through its in-depth treatment of Islamic art, focusing on disciplines such as architecture, calligraphy, ornamentation, and miniature painting. Its articles offer detailed analyses of artistic and theoretical achievements, highlighting the cultural and historical influences that have shaped this artistic identity.

Meanwhile, “Takvimi,” as the earliest publication—which continues to this day with the same mission—enriches this tradition by providing a deeper historical approach to Islamic art and related developments within the Albanian context.

For its part, “Edukata Islame” concentrates on the educational dimension, offering rigorous studies on the religious and cultural values of Islamic art. Through topics addressing Islamic monuments within and beyond Kosovo, as well as through calligraphic and ornamental illustrations, the journal promotes the importance of Islamic art in shaping identity and religious education.

Taken together, these three journals create a robust platform that supports the community’s cultural-religious identity, interweaving Islamic art, culture, and history into a shared narrative that illuminates the path toward a richer cultural and spiritual future.

Keywords: Islamic art, Dituria Islame, Takvimi, Edukata Islame, calligraphy



Corresponding author: Bashkim Mehani, bameba@hotmail.com



Citation: Mehani, Bashkim. “Arti islam në periodikët e Bashkësisë Islame të Kosovës (1945–1990).” In *Balkan Periodicals: The Trajectory of Islamic Thought in the Communist Period*, edited by Sevba Abdula, Ahmet Koroğlu, and Fatih Şabani, 43–65. Skopje: IDEFE Publications, 2025. <https://doi.org/10.51331/EB11BM>.

Hyrje

Falënderimi i përket Allahut, Krijuesit të gjithësisë dhe Rregulluesit të ligjësiave të jetës dhe ekzistencës. Paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi Profetin Muhamed (a.s.), familjen e tij fisnike, shokët e tij të përkushtuar dhe mbi të gjithë ata që ndjekin rrugën e së vërtetës deri në Ditën e Gjykimit.

Në diskursin bashkëkohor kulturor, arti islam shpeshherë qëndron në periferi të vëmendjes, ndonëse ai përfaqëson një shtyllë qendrore të trashëgimisë shpirtërore dhe estetike të qytetërimit islam. I ndërtuar mbi parime që ndërthurin shpirtëroren me estetikën, arti islam është një mënyrë e veçantë shprehjeje që refuzon kaosin dhe shëmtinë, duke synuar të bukurën si pasqyrë të së shenjtës. Në thelb të tij, ky art është shprehje e besimit dhe përjetimit kozmik islam, i përfaqësuar përmes kaligrafisë, arabeskave, ornamentikës, miniaturës dhe arkitekturës.

Konceptualizimi i artit islam si një fushë studimore e veçantë është zhvilluar sidomos nga shekulli XIX e tutje, nën ndikimin e historianëve të artit perëndimorë dhe më pas edhe nga dijetarë myslimanë, të cilët e panë nevojën për një kategorizim të kësaj trashëgimie të pasur. Në këtë kontekst, studimi i mënyrës se si arti islam është përfaqësuar në mendimin dhe median fetare shqiptare merr rëndësi të veçantë.

Kjo kumtesë synon të trajtojë përfaqësimin dhe diskutimin mbi artin islam në periodikët zyrtar të Bashkësisë Islame të Kosovës gjatë periudhës 1945–1990. Vërehet se trajtimi i kësaj teme ka qenë i pjesshëm, shpesh i kufizuar në dimensionin juridik (hallall/haram), ndërsa aspektet estetike, filozofike dhe kulturore të artit islam janë prekur rrallë dhe pa një zhvillim të thelluar. Në këtë kuadër, kumtesa përpiket të nxjerrë në pah dinamikën, qëndrimet dhe mungesat në lidhje me artin islam në këtë medium, duke e vendosur këtë analizë brenda kornizës më të gjerë të trajektores së mendimit islam në Kosovë në gjysmën e dytë të shekullit XX.

Literatura islame në gjuhën shqipe në Kosovë

Fillimet e shtypit islam në gjuhën shqipe mund t'i hasim në shekullin e tetëmbëdhjetë, kur disa dijetarëshqiptarë, të frymëzuar nga filozofia dhe letërsia islame orientale, i shkruan veprat e para me përmbajtje islame në gjuhën shqipe. Ndër autorët më të shquar të asaj kohe kanë qenë: Nazim Frakulla, Hasan Zyko Kamberi, Muhamed Kyqyku-Çami, Tahir ef. Gjakova, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Hafiz Ali Ulqinaku, Tahir ef. Lluka, Tahir ef. Popova, Hafiz Ali Korça etj.¹

1 Muhammet Pirraku, *Historia e letërsisë shqiptare* (Prishtinë, 1971).

Pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane dhe formimit të shtetit shqiptar më 1913, nisën të botoheshin revista dhe gazeta në gjuhën shqipe me përmbajtje fetare e kombëtare në qytete si Shkodra, Tirana dhe Gjirokastra. Këto botime qenë të përkohshme, derisa në vitin 1923 Këshilli Drejtues i Komunitetit Mysliman, nën udhëheqjen e H. Vehbi Dibrës, themeloi revistën mujore “Zani i Naltë”. Ajo trajtonte tema fetare, filozofike, shkencore dhe kombëtare, me kontribute nga figura të njohura si H. Vehbi Dibra dhe Hafiz Ali Korça.

Krahas tematikës fetare, revista përfshinte edhe materiale letrare, morale e sociologjike. Gjatë kohës së botimit, ajo pati ndikim të madh në edukimin fetar dhe ngritjen kulturore të shqiptarëve, duke përkrahur zhvillimet demokratike dhe përparimin kombëtar. Për këto arsye, “Zani i Naltë” mbetet një nga revistat më të rëndësishme në historinë e shtypit dhe kulturës shqiptare.²

Revista “Zani i Naltë” shënoi një pikë kthese në publicistikën islame shqipe, duke u bërë themel i shtypit fetar në gjuhën amtare për të gjitha trevat shqiptare. Ajo vazhdoi botimin deri në maj 1939, kur u ndërpre për shkak të pushtimit fashist të Shqipërisë. Po në vitin 1923, në Shkodër nisi të botohej edhe revista “Rruga e së Vërtetës” nën drejtimin e Hoxhë Kadri Prishtinës, një figurë me ndikim në çështjen kombëtare, por kjo u ndërpre shpejt për arsye të panjohura.

Pas ndërprerjes së “Zanit të Naltë”, Komuniteti Mysliman filloi botimin e revistës “Kultura Islame”, që zgjati deri në fillim të vitit 1945, kur regjimi komunist ndaloi shtypin fetar. Në këtë periudhë kontribuan emra të shquar si Dr. Behxhet Shapati. e të tjerë, me shkrime që trajtonin tema nga Kur’ani, filozofia, letërsia dhe etika. Mbyllja e kësaj reviste shënoi fundin e botimeve islame në Shqipëri deri në rënien e komunizmit në 1991.

Këto revista bashkuan figura të rëndësishme të dijes dhe kombit, me shkrime që mbështeteshin në burime islame dhe argumentim shkencor, duke synuar ndërgjegjësimin fetar, moral dhe arsimor të shqiptarëve. Ato ndihmuan në ngritjen e vetëdijes dhe përparimin shoqëror.

Në Kosovë e viset shqiptare nën sundim serb, shtypi dhe arsimit në gjuhën shqipe ishin të ndaluara. Pas vitit 1941, kur u përmbys Jugosllavia monarkiste, shqiptarët fituan të drejtën e shkollimit dhe të shtypit në gjuhën amtare. Revistat si “Zani i Naltë” dhe “Kultura Islame”, si edhe librat fetarë të kohës së mbretit Zog, shpërndaheshin edhe në Kosovë, ndonëse numri i lexuesve ishte i kufizuar. Megjithatë, për shumë shqiptarë, kjo përfaqësonte kontaktin e parë me fenë islame dhe alfabetin shqip në mënyrë të ligjshme.

2 Sherafedin Hoxha, “Gazetat dhe revistat myslimane fetare në gjuhën shqipe (1871–1944),” *Edukata Islame* (1990): 53–54.

Pas Luftës së Dytë Botërore, ndërkohë që në Kosovë u hapën shkollat shqipe, institucionet fetare si mejtepet dhe medresetë u mbyllën. Në vitin 1948, u formua Bashkësia Islame e Kosovës me në krye dijetarin H. Bajram Agani. Ai themeloi Medresenë “Alaudin” në vitin 1951 dhe ishte reformator i saj. Me përkrahjen e tij, u botuan librat “Ilmihali i vogël” (1957) dhe “Mësimi i shkurtër mbi namazin dhe Jasini sherifi” (1959), që përbënin një mundësi të rrallë për të rinjtë shqiptarë që të njihnin bazat e fesë islame përmes leximit. Kontributi i H. Bajram Aganit ishte vendimtar në ringjalljen e shtypit islam në gjuhën shqipe në Kosovë.

Rruga e literaturës islame shqip në Kosovë nuk ka qenë e lehtë. Ajo është përballur me një sërë pengesash, të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në ritmin dhe qëndrueshmërinë e zhvillimit të saj. Një ndër faktorët kryesorë ishte mungesa e institucioneve që do të ofronin formim fetar në shqip, çka bëri që shumë dijetarë të edukoheshin në gjuhë të huaja për shqiptarët – si osmanishtja, arabishtja apo turqishtja – dhe të mos e kishin të zhvilluar shkrimin akademik në gjuhën shqipe.

Situata u përkeqësua ndjeshëm gjatë regjimit socialist në Jugosllavi, kur feja u trajtua si një pengesë ideologjike për zhvillimin shoqëror. Në këtë periudhë, shumë aktivitete fetare u ndaluan ose u kontrolluan rreptësisht; botimi i librave me përmbajtje islame në shqip u ndërpre pothuajse krejtësisht, ndërsa personalitetet fetare u ndëshkuan ose u izoluan. Literaturës islame iu mohua një vend publik, duke e mbyllur pothuajse tërësisht rrugën e zhvillimit të saj. Ajo u mbajt gjallë vetëm në rrethe të ngushta, ku tekstet përdorshin në mënyrë të fshehtë, kryesisht në institucione të vogla lokale siç ishin mejtepet dhe xhamitë.

Një problem tjetër madhor ishte mungesa e përkthimeve të sakta dhe të thella nga gjuhët origjinale të literaturës islame. Përkthimet që ekzistonin shpesh nuk ishin rezultat i një pune të strukturuar akademike, por fryt i përkushtimit individual. Kjo ndikoi në saktësinë dhe besueshmërinë e materialeve, duke kufizuar edhe ndikimin e tyre tek publiku.

Së fundi, mungesa e një infrastrukture botuese serioze për literaturën islame në shqip e pengoi tej mase përhapjen e saj. Pa përkrahje nga shteti, pa shtëpi botuese të dedikuara dhe me mungesë të mbështetjes nga rrjetet ndërkombëtare, botimi i këtyre veprave mbeti i varur nga përpjekjet e shpërndara të individëve ose organizatave me mundësi të kufizuara. Kjo e bëri të vështirë ruajtjen dhe transmetimin e kësaj trashëgimie të rëndësishme shpirtërore dhe kulturore.

Pas ndryshimeve politike dhe shoqërore që solli fundi i regjimit komunist dhe shpërbërja e Jugosllavisë, Kosova përjetoi një periudhë të re të lirisë fetare, e cila pati ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e literaturës islame në shqip.

Hapesira e re e krijuar u shfrytëzua nga institucionet fetare, dijetarët dhe intelektualët myslimanë për të organizuar dhe institucionalizuar prodhimin dhe shpërndarjen e teksteve islame.

Një ndër zhvillimet më të rëndësishme të kësaj periudhe ishte themelimi dhe fuqizimi i shtëpive botuese me profil islam, të cilat filluan të botojnë në mënyrë të rregullt libra teologjikë, përkthime nga arabishtja dhe turqishtja, si dhe punime autoriale nga autorë shqiptarë. Gjithashtu, revista periodike si *Dituria Islame* u kthyen në platforma të rëndësishme për diskutimin e çështjeve fetare, kulturore dhe edukative, duke përfshirë edhe trajtesa mbi artin, etikën dhe identitetin islam në kontekstin shqiptar.

Përkthimi i Kur'anit në gjuhën shqipe mori një vëmendje të veçantë në këtë periudhë, me një sërë versionesh që u botuan me qëllim ofrimin e një përkthimi të kuptueshëm dhe të saktë për publikun shqiptar. Krahas Kur'anit, filluan të përkthehen edhe libra të jurisprudencës islame (fikh), traditës profetike (hadith) dhe mendimit etik-islam, duke krijuar një fond gjithnjë e më të gjerë burimor në gjuhën shqipe.

Megjithatë, kjo ringjallje nuk erdhi pa sfida. Problemet me cilësinë e përkthimeve, mungesa e redaktimit profesional, botimet jo të standardizuara dhe shpesh mungesa e një qasjeje bashkëkohore në interpretim janë çështje që vazhdojnë të prekin këtë fushë. Megjithatë, rritja e interesimit të brezave të rinj për studime islame dhe përfshirja e tyre në sferën akademike dhe botuese përbën një tregues pozitiv për të ardhmen e literaturës islame shqip.

Periodiku islam në gjuhën shqipe në Kosovë: Roli, sfidat dhe zhvillimi historik

Në vitin 1962, në Prishtinë nisi botimi i “Buletinit Informativ”, një periodik tremujor i Shoqatës së Ulemave. Fillimisht u publikua në serbokroatisht dhe shqip, ndërsa nga viti 1967 deri më 1970, vetëm në shqip. Botimi kishte karakter informativ dhe pasqyronte veprimtarinë organizative të Shoqatës dhe Bashkësisë Islame në Prishtinë.

Pas zhvillimeve politike që pasuan Plenumin e Brionëve dhe dobësimit të presi-onit serb ndaj Kosovës, Shoqata dhe Bashkësia intensifikuan aktivitetin botues. Në fund të vitit 1969, me nismën e H. Sherif Ahmetit, u publikua për herë të parë në shqip Takvimi për vitin 1970, i përgatitur profesionalisht për zonën e Kosovës. Krahas kalendarit, përfshiheshin rregullisht edhe shkrime me tematikë bashkëkohore.

Në fillim të vitit 1971, me vetëdijen për rëndësinë e fjalës së shkruar në gjuhën amtare, u mor vendimi për themelimin e revistës “Edukata Islame”. Megjithëse përballë mungesës së kuadrove të përgatitura dhe mungesës së literaturës në shqip, përkushtimi i bashkëpunëtorëve dhe diplomimi i teologëve në vendet islame sollën përmirësime të ndjeshme.

Revista “Edukata Islame” u redaktua me kujdes nga H. Sherif Ahmeti për mbi dy dekada. Ai, bashkë me një grup autorësh si Bajrush Ahmeti, Avni Aliu, Nexhat Ibrahimimi e të tjerë, kontribuan në përmbajtjen e saj, duke sjellë shkrime me theks edukativ, moral dhe kulturor. Përkundër vështirësive, si mungesa e shtypshkronjave të gatshme për botim fetar dhe kontrolli i rreptë ideologjik nga regjimi, revista u arrit të botohej falë ndihmës së Burhan Gashit nga shtypshkronja “Progres” në Mitrovicë.

Në një kohë kur feja shpesh përballej me propagandë negative dhe përbuzje institucionale, “Edukata Islame” u shndërrua në një platformë të vetme për të afirmuar mendimin islam në gjuhën shqipe. Për më tepër, ajo u bë referencë e domosdoshme për studiuesit e jetës fetare në trojet shqiptare. Revista mbeti gjallë për tri dekada, duke mbledhur rreth vetes një rreth të gjerë lexuesish dhe duke dëshmuar për rolin e fesë në ndërtimin kulturor e shpirtëror të shqiptarëve.

Më 1986, Kryesia e Bashkësisë Islame në Prishtinë, nën drejtimin e H. Jetish Bajramit, vendosi të hapë një tjetër kapitull në shtypin fetar me themelimin e revistës “Dituria Islame”. Fillimisht tremujore, ajo u shndërrua në periodik mujor me profil fetar-kulturor e shkencor që nga viti 1995. Megjithë sfidat, nga numri 18 e tutje, ajo arriti të justifikojë plotësisht ekzistencën e saj.


“Dituria Islame” mbetet një nga zërat më të qëndrueshëm në hapësirën mediale islame shqiptare, duke reflektuar vlera arsimore, etike dhe shpirtërore në përputhje me parimet islame dhe trashëgiminë kombëtare. Në një ambient të mbushur me shtyp laik pa kritere morale, kjo revistë përfaqëson një zë të nevojshëm dhe të fuqishëm në afirmimin e vlerave të mirëfillta.³

Arti islam në periodikun *Takvimi*

Që nga botimi i tij i parë në shqip në fundin e viteve '70, *Takvimi* ka qenë më shumë se një botim me të dhëna teknike mbi kohët e adhurimeve. Ai ka funksionuar si një hapësirë reflektimi dhe formësimi kulturor, ku përmes eseve, artikujve tematikë dhe analizave, është përcjellë një përfytyrim i gjallë i artit islam dhe vlerave të tij themelore.

3 Qemajla Morina, “Tridhjetë vjet të revistës ‘Edukata Islame,’” *Edukata Islame*, nr. 65 (2001): 5–7.

Duke pasur në qendër ritmin e kohës dhe përgatitjen shpirtërore të besimtarit, çdo edicion i *Takvim* është pasuruar me përmbajtje që pasqyrojnë ndërthurjen e fesë me përmasën estetike të jetës islame.



Arkitektura si shprehje e artit islam në Takvim

Dy nga kontributet më të dalluara në këtë fushë janë:

- Ibrahim Spahija – “Xhamia si objekt arkitekture, institucion edukativ dhe arsimor”⁴

Kjo trajtesë thekson funksionin shumëplanësh të xhamisë, jo vetëm si vend adhurimi, por si objekt arkitektonik me simbolikë të thellë, bartës i dijes dhe përkatësisë shoqërore. Nëpërmjet kësaj qasjeje, Spahija përforcon idenë se arkitektura islame është një art që formon vetëdijen komunitare, jo vetëm përmes formës së saj fizike, por edhe përmes funksioneve që mbart.

- Akademiku Hysref Rexhepi – “Arkitektura – arti i udhëheqjes në kulturën islame”.⁵ *Takvim*, nr.24, viti 1993, f. 89

Në këtë tekst, arkitektura shihet si një formë drejtimi kulturor dhe estetik, ku projektimi dhe ndërtimi nuk janë thjesht çështje teknike, por akt udhëheqjeje shpirtërore dhe shoqërore. Ky artikull përforcon idenë se arti islam është udhëzues i rendit moral dhe simbolet e tij janë gjithmonë të lidhura me konceptin e unitetit dhe harmonisë.

Ilustrimet në *Takvim* si reflektim i artit islam

Arkitektura islame në fotografi dhe vizatime

Këto elemente përfaqësojnë arkitekturën si një formë arti islam, duke i dhënë *Takvim* një funksion dokumentues të trashëgimisë materiale islame në treva të ndryshme.

4 Ibrahim Spahija, “Xhamia si objekt arkitekture, institucion edukativ dhe arsimor,” *Takvim*, nr. 6 (1975): 63–68.

5 Husref Rexhepi, “Arkitektura – arti i udhëheqjes në kulturën islame,” *Takvim*, nr. 24 (1993): 89–94.

Takvim përfshin një numër të madh ilustrimesh që përshkruajnë objekte të arkitekturës islame përmes, sidomos fotografitë që ilustrojnë kopertinat e *Takvimit*, si psh:

a. Fotografi me një ngjyrë (monokrome):

Xhamia “Sinan Pasha” – Prizren (e kaltër)

Xhamia e Sulltan Muratit – Prishtinë (e gjelbër)

Xhamia e Az’harit – Kajro

Qabeja në Mekë

Mesxhidul-Aksa – Jerusalem

Xhamia në Ferizaj, Prishtinë, Hajvali, Zagreb etj.

- Vizatimeve arkitektonike dhe historike:

Xhamia e Pejgamberit në Medine

Xhamia e Gazi Husrev Beut në Sarajevë

Ilustrim i Qabesë

Burrë dhe grua në namaz brenda një kornize mihrabi

- Makete arkitektonike:

Xhamia “Ebu Bekër” – Shkodër

Medreseja në ndërtim në Prishtinë

b. Korniza, ornamente dhe dizajne gjeometrike/florale

Këto elemente përfaqësojnë arabeskën dhe gjeometrinë, dy shtylla të artit islam që shmangin figuracionin dhe theksojnë përsëritjen, simetrinë dhe sublimen.

- Përfaqësuar gjerësisht në dizajne dekorative, si:

Korniza me motive florale njëngjyrëshe

Korniza me motive gjeometrike (me frezë, me skaje shtize)

Arabeska ovale, mozaikë me shkrime në stilin kufi hendesi

- Ilustrime të integruara me kaligrafi
- Korniza dekorative që rrethojnë pjesët tekstuale
- Shkrime që janë vendosur brenda ornamenteve florale apo gjeometrike

Kjo tregon një shkrirje të artit me funksionin, një tipar tipik i artit islam, ku estetika dhe përmbajtja nuk ndahen, por përforcojnë njëra-tjetrën.

c. Kaligrafia islamike

Kaligrafia është kryefjala e artit islam në faqet e *Takvim*, prezente në forma të ndryshme, nga titujt e temave, e deri te zbukurimi i hapësirave. Ajo përçon estetikë shpirtërore dhe përkushtim, duke i dhënë karakter të veçantë vizual çdo faqe që e përmban. Ja disa shembuj:

- **Kaligrafi me stil thuluth** (shumica e besmeleve, sureja Ihlas, dhe ajete e hadithe tjera):

“Allahu la ilahe il-la huvel hajjul kajjum”

“InAllahe ala kuli shejin kadir”

Dhjetëra shembuj të “Bismil-lah”-it

- **Stili rik’a** për ajete të shkruara me dorë:

El-Isra, El-Bekare, En-Nur, En-Nisa etj.

- **Stili nas’h** për shtypshkrime dhe fjalë si “تقويم” (kalendar)

3. Tipologjia dhe rëndësia e ilustrimeve në *Takvim*

Kategoritë	Përfaqësimi	Roli në artin islam	Sasia
Arkitektura Islame	foto, vizatim	Dokumentim, përçim identiteti kulturor	20 ilustrime dhe foto
Korniza dhe ornamente	dizajn	Estetikë dekorative, simbolikë e pafundësisë	21 dizajne
Kaligrafia	thuluth, rik’a	Art shpirtëror, mesazh i bukurisë hyjnore	17 kaligrafi dhe shkrim dore

Konkluzion: Periodiku “*Takvim*”, ka funksionuar si një arkivë e heshtur e artit islam, duke mbartur vlera të shumanshme: formuese, edukative dhe estetikisht ndriçuese. Përmes trajtesave të autorëve të ndryshëm, janë ndriçuar aspekte themelore të estetikës islame në arkitekturë, teori arti, reflektime kulturore dhe përshtime përfaqësuese. Ky publikim vjetor ka ndihmuar në ndërtimin e një diskursi të brendshëm mbi artin islam në Kosovë, duke lidhur gjuhën e besimit me gjuhën e bukurisë dhe të qytetarisë.

Mungojnë shumë tema që e trajtojnë artin islam, duke filluar nga historia dhe gjeografia e këtij arit, fushat dhe mjetet shprehëse, kronologjia e zhvillimit të tij, etj.

Prezantimi i artit islam në revistën *Edukata Islame*

Rrugëtimi prej pesë dekadash i revistës *Edukata Islame*, ka qenë dhe do të mbetet një prej shtigjeve të ndritura nëpër të cilat kaloi shtypi islam në Kosovë. Një nga dimensionet që ka gjetur hapësirë në të është edhe arti islam, në format e trajtat e ndryshme të tij, si pjesë e pandashme e kulturës dhe civilizimit islam.

Trajtimi teorik i artit islam

Duke shfletuar me kujdes të gjitha faqet e kësaj reviste, për të mbledhur nga gjurmët e shkrimeve pjesën më karakteristike të artit në përgjithësi, e të atij islam posaqërisht, pra kritikën dhe poetikën e saj, vërejmë një prezencë jo edhe aq të saj.

Që nga numri 31-32, i vitit 1981, fillon që të botohen artikuj që trajtojnë: historikun e xhamive, analizave arkitekturore, hulumtimeve arkivore të dorshkrimeve, mbishkrimet mbivarrore, filozofisë së artit, historisë së kaligrafisë, etj, dhe atë përmes 63 kontributeve.

Këtu nuk do të ndalemi me paraqitjen e të gjithë titujve të këtyre trajtesave, e që do të mund t'i gjeni në versionin për botim, por sa për ilustrim po i përmendim vetëm disa:

Dr. Hasan Kaleshi, “Gjendja e monumenteve islame te Kosoves ne vitet e pesedhjeta te shekullit njezet”,

Aleksander Meksi, “Probleme dhe aspekte të arkitekturës së xhamive në Shqipëri”,


Jashar Rexhepagiq, “Faltoret, institucionet dhe qendrat islame në Kosovë (Xhami, teqe, kutubhane, vakefe)”,

Qemajl Morina “Kaligrafia arabe”,

Sadik Mehmeti “Monedhat e sulltanëve osman”

Ajni Sinani dhe Mimoza Sinani, “Kultura dhe civilizimi islam”,

Ramadan Shkodra, “Xhamia “Sulltan Murat (792h/1389), monumenti më i vjetër islam në Prishtinë”,



Fridjof Shuon “Mendime rreth artit sipas vështrimit tradicional” etj.

Sigurisht mungesa e këtyre temave në fillet e para të daljes së kësaj reviste, arsyetohet nga material problematike e kësaj fushe, sa delikate, po aq edhe specifike, apo edhe nga vet natyra e revistës dhe synimi i redaksive të saj, që në të të trajtohen tema me interes më të përgjithshëm, e që i shërbejnë një pjese me të gjërë lexuesisht.

Ilustrimet

Arkitektura

Që nga numri 43, në vazhdimësi faqet e revistës janë ilustruar me foto të arkitekturës islame, vendore e botërore. Ato i gjejmë në brendi të revistës, por edhe në kopertinat e saj.

Ja disa nga to:

Nr. 43, kopertin e fundit ilustrohet me foton e Medresesë “Alauddin” në Prishtinë

Nr. 65, foto e hamamit të Prizrenit

Nr. 65, Teqeja halveti në Rahovec dhe doreshkrimet e saj (foto e Teqes)

Nr. 191, Foto nga xhamitë monumentale në Prizren

Nr. 301, Foto e xhamisë Zejtunie

Nr. 63, Foto e xhamisë “Sulltan Murat” në Prishtinë

Nr. 149, foto e Qendrës Islame shqiptare-amerikane në Nju Jork

Nr. 67, Sikicë dhe fotografi e Namazgjahut të Opojës, etj.

Fotografitë dhe skicat, kryesisht janë ilustrim i tekstit përcjellës, e ndonjëherë edhe në funksion të zbukurimit dhe kombinimit grafik me tekstin.

Në shumicën e rasteve tregohet vetëm arkitektura e jashtme e këtyre ndërtesave, pa prezantimin e arkitekturës së brendshme, enterierit.

Kaligrafia

Kaligrafia apo bukurshkrimi arab, ka një prezencë të dukshme në faqet dhe kopertinat e revistës, që nga numri i parë i saj, ku janë reprodukuar mbi 83 sosh, prej tyre kaligrafi të huazara botërore, por edhe të autorëve vendor, të cilët në mungesë teknike, kanë përshkuar me dorë tekstet arabe të ajeteve, haditheve apo lutjeve.

Janë përfshirë pesë lloje të kaligrafisë, duke filluar nga: nas'h, thuluth, farisi, nestalik, kufi (me nënlojet e tij: kufi hendesi dhe sumbuli) etj, pjesa më e madhe e tyre janë botuar në brendi të revistës, në shtyp bardh e zi. Nga numri 63-64 i vitit 1997, fillon të aplikohet edhe tipografia kompjuterike e tekstit arab me fonte nga me te ndryshmet.

Në rastet kur përmes kaligrafisë janë paraqitur ajete apo hadithe, janë shoqëruar edhe me përkthim në gjuhën shqipe.

Disa prej tyre janë përsëritur edhe shumë here në numra të ndryshëm, qoftë si përmbajtje apo edhe si formë, si psh. Tituli i revistës “Et-terbijeh el islamijeh”, ‘besmeleja’, e përsëritur në mbi 32 vende, apo sentence: ‘La ilahe il-lall-llah’ e cila është përsëritur në 9 vende me të njëjtën kaligrafi.

Kjo sigurisht ka ndodhur për mungesë të një fondi të posaqëm të kaligrafive, apo edhe për qëllime didaktike, me të cilat është synuar të adoptohet syri i lexuesit në një format të këtyre teksteve.

Analizë e pranisë së kaligrafisë në revisten *Edukata Islame*

Kaligrafia islame si prani estetike dhe edukative në revistën *Edukata Islame*, fragmenteve të shkrimit dorëshkrimor dhe elementeve dekorativë në këtë revistë, përbëjnë një bartës të qëndrueshëm të trashëgimisë estetike të artit islam në kontekstin shqiptar.

Revista *Edukata Islame* karakterizohet nga një përdorim i gjerë i kaligrafisë, e cila, ndonëse nuk është qëllim në vetvete, e shoqëron vazhdimisht përmbajtjen si një mjet që i jep formë dhe shpirt mesazhit fetar. Përdorimi i frazave themelore si “La ilahe ilallah”, “Bismilah” apo ajete të përzgjedhura nga Kur’ani, zënë vend qendror në strukturën vizuale të faqeve. Këto nuk janë thjesht zbukurime, por bartin funksionin e shenjës së pranishme, ku fjala e shpallur përçohet jo vetëm përmes leximit, por edhe përmes konturit estetik dhe hieratik të formës së saj.

Shumëllojshmëria stilistike dhe përfaqësimi i traditave klasike

Ilustrimet kaligrafike janë realizuar në një gjeografi stilesh që përfshijnë:

Thuluth – i përdorur për ajete madhore, për solemnitet dhe vizualizim monumental;

Kufi – me variacione të thjeshta dhe “kufi hendesi”, që pasqyron sistemin logjik të simetrisë dhe përsëritjes, të pranishëm sidomos në ilustrimet e frazës *et-terbijetul islamijetu*;

Rika'a – me një rrjedhë më të lirë, përdorur shpesh në përshkrimet e sureve dhe hytbeve;

Nash dhe nestalik – të përdorura për citime dhe fragmente me karakter dokumentues ose memorial (si faksimilet e dorëshkrimeve historike).

Farisi – i pranishëm në vargje dhe urtësi që mbartin tone më poetike.

Stilet më të përdorura:

Stili	Funksioni estetik
<i>Thuluth</i>	Shpreh solemnitetin dhe madhështinë; përdorur për ajete madhore dhe formula të rëndësishme
<i>Kufi</i>	Linjë e rreptë, tradicionale; përdorur për tituj ose formula themelore si “bismillah”
<i>Kufi hendesi</i>	Përsëritje dhe simetri; i lidhur ngushtë me dizajnin arkitektonik dhe grafik
<i>Nash</i>	Përdorim për tekst të lexueshëm, shpesh në pjesët shpjeguese
<i>Rika'h</i>	Format më të rrjedhshme, përdorur në shkrime dorëshkrimore, për ajete ose lutje
<i>Farisi</i>	Elegancë poetike, përdorur në citime poetike ose refleksione morale
<i>Nestalik</i>	Stil persian, përdorur në faksimile ose dorëshkrime të vjetra

Ky mozaik stilistik nuk është i rastësishëm; ai përfaqëson një lidhje të qëllimshme me traditat kaligrafike të trashëguara nga qendrat klasike të artit islam, duke u bërë pjesë e gjuhës vizuale të edukimit fetar edhe në realitetin shqiptar.

Ornamenti dhe dekorimi

Si pjesë e pandashme e arkitekturës islame, atë e gjejmë që nga periudhat e hershme e deri më sot, kudo në territoret e përfshira nga kultura dhe civilizimi islam.

Një pjesë e saj, në revistë është prezantuar së bashku me xhamitë, e në disa raste si kuadro të ndara prej tyre, por që pëgjithësisht ajo ka zbukuruar kopertinat e revistës dhe brendësinë e saj, që nga botimi i parë, e gjer më sot.

Deri në botimet e fundit janë paraqitur gjithësejt 60 ornamente, ku prej tyre 51 ornamente me motive flurore, 8 me motive gjeometrike, dhe 1 ornament i shoqëruar me kaligrafi.

Nuk ka ndonjë rast kur ato janë studiuar si të veçanta, duke specifikuar: karakteristikat e tyre, materialet me të cilat janë punuar, si dhe vlerën artistike, por i

mбетет lexuesit (apo më drejt -shikuesit) që të kënaqet e të magjepset nga bukuria e tyre si ilustrime.

Miniatūra

Sa i përket kësaj kategorie, mund të themi se nuk e hasim në këtë rëvistë, përveç se në një rast. Kjo ndoshta edhe nga fakti se përgjithësisht sipas traditës islame, paraqitjet e figurave të gjalla nuk parapëlqehen e madje edhe janë të kritikuar në gjykimin fetar, edhe pse në botën islame, në ndikimin e artit iranian, apo përmes tij nga arti kinez, miniatūra është e kudondodhur në ilustrimet e librave fetar të kultuës dhe historisë, që ishin në funksion të konkretizimit të ngjarjeve e ndodhive mbi të kaluarën e lavdishme islame, që nga historia e pejgamberi tonë, Muhamedit a.s., e deri në periudhën e vonshme të historisë islame të Perandorisë Osmane.

Ndërthurja e përmbajtjes edukative me formën estetike

Në *Edukata Islame*, kaligrafia nuk vjen si dekor, por si pjesë funksionale e edukimit fetar. Për shembull, në temat që trajtojnë edukatën shpirtërore, morale apo sociale, përdorimi i një ajeti kaligrafik e vendos mesazhin në një dimension estetik, që i shërben edhe përjetimit shpirtëror të lexuesit. Kaligrafia në këtë kontekst nuk është as neutralizuese dhe as ilustrative në kuptimin e zakonshëm të figurës në media; ajo është komunikuese në thelb, duke shpërfaqur përmes formës vizuale një trajtë të bukurisë hyjnore.

Elementë të tjerë vizualë dhe simbolikë

Përveç kaligrafisë, revista përfshin edhe:

Hydbe të shkruara me dorë, që ruajnë karakterin autentik të traditës së transmetimit;

Faksimile të dorëshkrimeve me nestalik, të cilat përçojnë kujtesë kulturore dhe prestigj të trashëgimisë së shkruar;

Dekore të kufizuara ornamentale, si ilustrimi florur “punim imi”, që i japin rëvistës një prekje personale dhe kontur manual;

Fotografi e objekteve arsimore si Medreseja “Alauddin”, e cila i jep kontekst hapësinor lexuesit për realitetin edukativ islam në Kosovë.

Përmbledhje analitike

Kategoria	Përfaqësim në revistë	Funksioni në artin islam
Kaligrafia	Mbi 80% e ilustrimeve, me shumë stile	Shprehje vizuale e shpirtërores dhe dije islame
Shkrimi dorë & shtypi	Përdorim për ajete, lutje, sure, hytbe	Respekt për autenticitetin dhe origjinalitetin fetar
Dizajne ornamentale	Pak raste (ornament florur)	Zbukurim pa figuracion – parim thelbësor i artit islam
Fotografi	Shumë e kufizuar (vetëm 1 rast – Medreseja)	Dokumentim vizual – jo estetik dominues në këtë revistë

Revista *Edukata Islame* shquhet si një ndër shembujt më përfaqësues të ndërturjes mes edukimit fetar dhe estetikës së artit islam në hapësirën shqiptare. Ajo nuk është thjesht një botim me përmbajtje didaktike, por një medium që kultivon ndjeshmëri vizuale dhe shpirtërore te lexuesi përmes prezantimit të kaligrafisë tradicionale, dorëshkrimeve dhe elementeve pamorë me rrënjë në trashëgiminë islame. Përkushtimi ndaj stileve klasike të shkrimit, ruajtja e formave të vjetra të dorëshkrimit dhe përzgjedhja e përmbajtjeve me theks kuranor e bëjnë këtë revistë një model të shkëlqyer të artit të shkruar islam, që i fton lexuesit jo vetëm të mësojnë, por edhe të përjetojnë estetikisht shpirtëroren.

Megjithatë, duke u nisur nga fakti se arti islam është një disiplinë e pashtershme e trashëgimisë sonë, hapësira e dedikuar për të ngelet e vogël, si për nga paraqitja e saj në planin vizual, ashtu edhe nga trajtimi i saj në aspektin teorik, filozofik e historik të saj.

Po ashtu numri i punimeve orgjinale nga autorët tanë, thuajse është fare i papërfillshëm, për çka duhet t'i inkurajojmë më tepër studiuesit e kësaj fushe për të kontribuar me artikuj, punime por edhe përkthime, në mënyrë që arti islam të marr vëmendjen e duhur të opinionit publik dhe lexuesit të përkushtuar.

Prezantimi i artit islam në revistën *Dituria Islame*

Duke marrë parasysh se një revistë që bartë, pos emrit, edhe një mision të madh e fisnik mbi vete, e që ka për qëllim t'i ofroj lexuesit të saj sa besim, dituri e informim, po aq edhe freski dhe “qasje” estetike, një nga elementet të cilat e

kanë përcjellë që nga fillimi i saj atë e që është pjesë e pandashme e kulturës islame është edhe arti islam.

Vlerat universale etike dhe estetike të Islamit, domosdoshmërisht të jenë pjesë e çmuar edhe e kësaj reviste, por:

Sa është përfshirë dhe trajtuar ky dimension kulturor e estetik i Islamit?

A i është dhënë hapësirë e mjaftueshme dhe adekuate, krahas temave tjera që përmban revista?

Cilat janë fushat që janë prekur më shumë, e cilat më pak?

Cilët janë autorët që kanë kontribuar në këtë temë etj., janë vetëm disa nga pyetjet të cilave synon t'u përgjigjet kjo kumtesë modeste.



Ilustrimet

Në këtë rast do të ndalemi në katër disiplina themelore të artit aplikativ islam e që janë: arkitektura, kaligrafia, ornamenta dhe miniatura.

Arkitektura islame - xhamitë

Arritjet më të larta në artin islam janë bërë në arkitekturë, e kjo në veçanti në ndërtimin e xhamive. Edhe pse vërehen huazime nga civilizimet e ndryshme ku është përhapur Islami, ajo ka formësuar specifikat e veta si për nga përmbajtja e funksioni, ashtu edhe për nga elementet figurative me të cilat lehtë mund të dallohet nga objektet tjera.

Për shkak të kësaj peshe të madhe artistike dhe funksionit të saj, pra “objekt ku adhurohet Allahu xh.sh.”, imazheve të xhamive u është dhënë hapësirë më e madhe në revistën *Dituria Islame*.

Që nga numri 1, në vazhdimësi faqet e revistës janë ilustruar me foto të xhamive vendore dhe botërore, të cilat paraqesin veçantinë dhe bukurinë e arkitekturës islame. Ato i gjejmë në brendi të revistës, të printuara pa ngjyra (apo bardh e zi), por shpeshherë edhe në kopertinat e revistës, me ngjyra dhe në format të plotë.

Pjesa më e madhe e këtyre ilustrimeve me fotografi janë vendosur me qëllim të zbulimit të hapësirave të revistës, apo për të dokumentuar ndonjë vend, histori apo eveniment që lidhet me to, por ndonjëherë ato marrin edhe peshën qendrore në tema të caktuar të revistës, për të cilat janë dhënë informata si: emri i xhamisë, lokacioni, viti i ndërtimit, ndërtuesi, parametrat, e kështu me radhë.⁶

Në shumicën e rasteve tregohet vetëm arkitektura e jashtme e tyre si ndërtesë, pa prezantimin e arkitekturës së brendshme, e cila po ashtu ka një vlerë mjaftë të madhe arkitekturore, kjo ndoshta edhe në mungesë të një fondi të fotografive në redaksinë e revistës, apo në mungesë të teknikës për fotografim profesional të hapësirave të brendshme, kur është fjala për xhamitë e vendit tonë, për shkak të mungesës së ndriçimit adekuat.

Prandaj pjesa më e madhe e këtyre xhamive na ofrohet më tepër si dokumentim dhe ilustrim, sesa mundësi për t'u njohur me vlerat e tërësishme që ka ai objekt.⁷

Kaligrafia

Si një degë e artit islam, kaligrafia apo bukurshkrimi arab, ka luajtur një rol të rëndësishëm në zbulimin e faqeve të “Diturisë Islame”, e ndonjëherë në rolin e përmbushjes tematike.

Janë përfshirë po thuajse të gjitha tipet e kaligrafisë arabe si: kufi, nas’h, thuluth, rika, divani, talik, nestalik, tugra etj.⁸ Pjesa më e madhe e tyre është botuar në brendi të revistës dhe në kohën kur ajo botohej pa ngjyra, mirëpo në disa raste është botuar edhe në kopertina të revistës me shtyp kolor.

Duke qenë se ato janë kryesisht ajete të Kuranit, hadithe apo edhe ndonjë fjalë e urtë arabe, jo gjithëherë i është bashkangjitur edhe përkthimi në gjuhën shqipe, çka e zbehë funksionin e tyre, përveç atij vizual.

Në përgjithësi këto vepra arti janë huazime, e në ndonjë rast edhe origjinale nga artistë vendor.⁹

Krahas këtyre kaligra-five, në ndonjë rast gjejmë edhe manuskripte të librave të shkruar nga kaligraf të ndryshëm, që nga periudha emevite e deri në kohën e bejtexhinjve, si argument se kaligrafia ka funksionuar vazhdimisht në kulturën islame, nga lindja e saj e deri në kohën e vonshme, në të gjitha vendet e botës myslimane, pra edhe tek ne.

6 Elez Osmani, “400 vjetori i xhamisë së Kaçanikut,” *Dituria Islame*, nr. 61 (1994): 17.

7 *Dituria Islame* (pa vit), nr. 63, 64, 65, foto e kopertinave të revistës.

8 *Dituria Islame*, nr. 1, 2, 3, 26, 45, 46, 48.

9 *Dituria Islame*, nr. 101, 102–103, 104, 105–106, 108–109, etj.

Ornamenti dhe dekorimi

Një element tjetër i prezantuar në revistën *Dituria Islame*, krahas arkitekturës dhe kaligrafisë është edhe ornamentimi.

Si pjesë e pandashme e arkitekturës islame, atë e gjejmë në xhamitë dhe ndërtesat tjera sakrale e profane që nga periudhat e hershme e deri më sot, kudo në territoret e përfshira nga kultura islame.

Një pjesë e saj, në revistë është prezantuar së bashku me xhamitë¹⁰, e në disa raste si kuadro të ndara prej tyre, gjithnjë në funksion të ilustrimit dhe mbushjes së hapësirave brenda faqeve të revistës.

Nuk ka ndonjë rast kur ato janë trajtuar si të veçanta, duke specifikuar: karakteristikat e tyre, materialet me të cilat janë punuar, si dhe vlerën artistike, por i mbetet lexuesit (apo më drejt -shikuesit) që të kënaqet, të magjepset nga bukuria e tyre vetëm me shikimin e tyre.

Miniatura

Edhe miniatura ka një rëndësi të veçantë në artin islam, e cila fillimisht ndikohet nga huazimet persiane, e pastaj edhe nga ato mogule e turke, dhe shfaqin kulmin e arritjeve në pikturën e artit islam. Janë quajtur “miniaturë”, ngase ato kryesisht janë bërë për të ilustruar librat dhe janë punuar në përmasa të vogla. Një pjesë e tyre janë të çmuara botërisht si vlera të artit botëror.

Në to kryesisht paraqiten ngjarje historike dhe rrëfime nga e kaluara e lavdishme islame, por duke marrë parasysh se pikturimi i figurave të gjalla ka hasur në kritikë të rreptë në mese të ndryshme islame, ajo nuk gjeti përkrahje për tu zhvilluar krahas pikturës tjetër në botë, prandaj përdorimi i saj mbeti shumë i kufizuar. Nga ky shkak edhe në revistën tonë përdorimi i tyre për të ilustruar ndonjë ngjarje apo ndodhi islame nuk është përdorur thujse aspak, apo me përjashtime të vogla,¹¹ ngase fryma e përgjithshme edhe tek ne sa i përket ndjeshmërisë së pikturimit në përgjithësi, e aq më tepër i figurave qendrore islame, të cilat do të mund të ishin protagonistët e këtyre rrëfimeve, nuk e favorizon një gjë të tillë.

Ato mund t'i gjejmë në disa raste vetëm si skicime urbane, pamje të objekteve dhe hapësira të caktuara të qyteteve islame, e sidomos të Mekës dhe Medinës, por që janë vizatime të vjetra dhe karakterizohen me thjeshtësinë e realizimit të tyre.¹²

10 *Dituria Islame*, nr. 100 (1998): 19.

11 *Dituria Islame*, nr. 101 (1998): 35.

12 *Dituria Islame*, nr. 215 (2008): 21.

Trajtimi teorik i artit islam

Të flitet mbi artin në përgjithësi dhe raportin e tij me religjionin, e hasim nga numri 19 deri te numri 25 i revistës, në fragmentet e shkëputura nga libri “Islami mes Lindjes dhe Perëndimit” të autorit Alija Izetbegović e të përkthyer nga Eqrem Kryeziu. Aty trajtohen temat si: “arti dhe shkenca”¹³, “arti dhe religjioni”¹⁴, “arti dhe ateizmi”¹⁵, “bota konkrete e artit”¹⁶ dhe “artisti dhe vepra e tij”¹⁷ etj, ku për herë të parë lexuesit të revistës i mundësohet qasje në të kuptuarit filozofik të perceptimit të artit nga një autor bashkëkohor mysliman.

Nga numri 104 deri në numri 132 (2000-2001), në 17 vazhdimet, janë botuar pjesë të librit “Xhamia pasqyrë e Islamit” të filozofit francez Roger Garaudy (Rozhe Garodi).

Besimi dhe praktikata e Islamit janë pasqyruar në arkitekturën e xhamisë. Megjithatë, mendimi i tanishëm dominues perëndimor në thelb ka vendosur kufijtë e perceptimit bazuar vetën në fuqinë e njeriut, në vend të eksplorimit nëpërmjet fuqisë së imagjinatës. Prandaj, estetika e xhamisë nuk mund të gjykohej drejt në përputhje me bazën e kriterëve të estetikës perëndimore - antropomorfe. Garaudy ka zbuluar lidhjen midis dekorimeve dhe ajeteve kuranore në bazë të kërkimit vetanak të tij gjatë gjithë jetës për transcendencën, mendimet e të cilit ai i shpreh në “Xhamia pasqyrë e Islamit”, ku na lejon që bashkë me të të eksplorojmë edhe më tej aspektet shpirtërore të artit dhe arkitekturës islame. Kjo është një pasqyrë e mendimeve nga koncepteve kyçe, e cila promovon dhe kontribuon një përpjekje të tillë, me të cilën mund të hulumtohet dhe zbërthehet arkitektura e xhamive.

Këtu në mënyrë të shkëlqyeshme dhe mjaft mbresëlënëse janë mbledhur dhe pasqyruar perlat e arkitekturës botërore islame, me një stil jo të zakonshëm dhe lehtë të kuptueshëm për lexuesin e thjeshtë, por me një poetikë të artit, kombinuar me kritikën, historinë dhe filozofinë që përmbajnë këto vepra arti.

Ja një fragment i shkurtër i shkëputur nga kapitulli: “Prej Qabesë në Medinë: Haxhi te burimi”

“...Nën rrezet e dritës së reflektorëve, oborri vigan, i shtruar me mermer, është aq i bardhë e i tejdukshëm, sa që ngjan me një fushë akulli. Në qendër qëndron

13 *Dituria Islame*, nr. 19 (1990): 27.

14 *Dituria Islame*, nr. 20 (1990): 12.

15 *Dituria Islame*, nr. 21 (1991): 9.

16 *Dituria Islame*, nr. 22-23 (1991): 29.

17 *Dituria Islame*, nr. 25 (1991): 40.

kubi i gurtë, lëvizësi i palëvizshëm, boshti i gravitacionit i asaj galaksie të qenieve njerëzore...”¹⁸

Libri në fjalë i Garodit, i përkthyer me kujdes dhe saktësi nga gjuha angleze prej Armend Grudës krahas autorit zviceran Titus Burckhardt (Titus Borkhart), konsiderohet nga veprat më të arrira në kritikën e artit islam, prandaj mendoj se është një arsye e fortë që ky material të botohet i tëri si libër nga shtëpia botuese *Dituria Islame*, e cila mund të kishte privilegjin dhe ekskluzivitetin e botimit të një vepre të tillë në gjuhën shqipe.

Në numri 144-145 janë botuar dy vazhdime të artikullit me titull “Arti dhe arkitektura islame”¹⁹ pa autor, të përkthyer nga gjuha angleze prej Eral Begës, ku përmbledh një historik të shkurtër të zhvillimit të artit islam si dhe karakteristikat e tij, ngjashëm me artikullin tjetër “Arkitektura-arti udhëheqës në kulturën islame”²⁰ të akademik. Husref Rexhiq, e të përkthyer nga Nexhat Ibrahimimi.

Në disa numra janë botuar reportazhe nga vizitat e qyteteve dhe monumenteve islame si: “Stambolli qytet i 1001 xhamive”, nga Elez Osmani²¹, “400 vjetori i xhamisë së Kaçanikut”²² po ashtu nga Elez Osmani, “Një ditë në xhaminë e madhe të Parisit”²³ nga Mehmet Zhinipotku, “Jerusalemi qyteti islam”²⁴ Muahmed el Uekil, etj.

Në numrin 125-126 në dy vazhdime është botuar intervista me Andrash Ridimajerin, Ekspert i Historisë së Artit Islam, e zhvilluar nga Qemaj Morina, ku flet për rëndësinë e artit në botën islame, dhe vlerat që bartë ajo deri në ditët e sotme.²⁵

“Fisnikërimi i pikturës murale”²⁶ është një recension nga Dr. Muahmet Pirraku i Monografisë: “Arabeska origjinale ne xhamitë e Kosovës Lindore 1984-1994)” të autorit Demir Behluli. Botuar në numrin 277²⁷, në të cilin shpreh fjalë miradije për punën e këtij piktori të dalluar në zbukurimin e xhamive shqiptare me elemente autoktone, si dhe rëndësinë që ka libri për të kuptuar nivelin e pikturës murale të xhamive tona.

18 *Dituria Islame*, nr. 108-109 (1999): 28.

19 *Dituria Islame*, nr. 144-145 (2002): 29.

20 *Dituria Islame*, nr. 65 (1995): 26.

21 *Dituria Islame*, nr. 61 (1994): 30.

22 Po aty, 17.

23 *Dituria Islame*, nr. 62 (1994): 25.

24 Po aty, 28.

25 *Dituria Islame*, nr. 125 (2000): 41, dhe nr. 126 (2000): 38.

26 *Dituria Islame*, nr. 277 (2013): 62.

27 Po aty.

Në tre numra të revistës: 51, 52, e 60, një kënd i veçantë i kopertinës së fundit të revistës i është dedikuar arkitekturës islame, përmes ilustrimit me fotografi dhe përshkrimit me tekst të monumenteve islame, si i xhamisë së madhe “Sulltan Fatih” në Prishtinë, “Xhamive të Beogradit dhe fatit të tyre të keq, dhe xhamisë së Plumbit në Shkodër, etj. por kjo hapësirë e dedikuar për prezantimin e xhamive nuk ka vazhduar më shumë se kaq.

Në disa raste është dhënë edhe ndonjë lajm për hapjen e ekspozitave të artit islam në vend dhe jashtë tij, por këto informata nuk kanë qenë të mjaftueshme, kur marrim parasysh se pas luftës në Kosovë janë hapur mbi 10 ekspozita të artit islam nga artistët vendor dhe ndërkombëtarë, e për të cilat nuk është publikuar asnjë informatë në *Diturinë Islame*, e aq më pak të ketë pasur ndonjë kritikë, apo vlerësim të këtyre veprave artistike.

Menjëherë pas luftës së Kosovës, është bërë evidentimi i xhamive dhe objekteve tjera të kulturës islame të dëmtuara apo të rrënuara, të cilat janë prezantuar në revistë me foto dokumentuese dhe evidentim të dëmeve të shkaktuara nga okupatori serb, ku krahas tyre janë dhënë edhe detaje të historikut, si dhe vlerave arkitekturore të këtyre objekteve.

Periudha tjetër përfshinë fazën e rindërtimit, meremetimit apo të ndërtimit të xhamive të reja në Kosovë, ku nuk mungojnë informata mbi ceremonitë e inaugurimit të tyre, por më pak hasim në informatat që paraqesin anën artistike dhe arkitekturore të tyre, gjë e cila lë një boshllëk të madh dokumentimit faktografik dhe artistik të monumenteve të reja islame.

Përfundim

Në pyetjen se a është shtjelluar mjaft arti islam si fushë dhe me një plan të caktuar paraprakisht, s’do mend se përgjigjja do të ishte se jo kënaqshëm, për një revistë që pretendon të jetë profesionale edhe në dimensionin kulturor islam. Mirëpo, duke marrë parasysh kushtet dhe rrethanat në të cilat ka lindur dhe zhvilluar ky medium, mund të themi se që nga numri i parë, trajtimi i artit islam nuk është lënë pasdore asnjëherë, përkundrazi ka pasur një ngritje të vazhdueshme sasiore dhe cilësore të temave që e prekin, si dhe ilustrime që e dëshmojnë atë.

Ajo që kërkohet në të ardhmen është:

1. Qasja ndaj kësaj fushe me një plan më substancial, duke përfshirë të gjitha anët dhe dimensionet e saj, dhe në mënyrë sa më profesionale. Në këtë plan do të përfshiheshin: Historiku i artit islam, Filozofia e artit islam, çështje fikhere për artin islam, kritika e artit islam etj.

2. Të ketë një kënd, apo rubrikë të ndarë në çdo numër të revistës që i dedikohet atij, duke përfshirë artin islam që nga periudhat më të hershme, e deri më sot, duke e ilustruar me foto, në mënyrë që të jetë më e kapshme edhe për lexuesin e rëndomtë të revistës, por edhe me shkrime të nivelit të lartë të kritikëve të artit, e cila do t'u shërbente studentëve dhe studiuesve të kësaj fushe në trevat tona.
3. Në faqet e “Diturisë Islame”, të prezantohet edhe më fuqishëm krijimtaria artistike e kohës së re. Të informohet lexuesi artdashës me rrjedhat bashkëkohore të artit islam si në vend ashtu edhe jashtë tij, sidomos në këtë kohë kur imazhi i bukur i Islamit është njollosur dhe dëmtuar rënd nga myslimanët injorantë dhe jomyslimanët me qëllim të keq.

LITERATURA

Libra

- Bashkësia Islame e Kosovës. 2019. *Literatura islame në gjuhën shqipe në Kosovë (1957–2017): Fillet, tradita, sfidat dhe perspektiva. Përmbledhje kumtesash nga tryeza shkencore (Prishtinë, 27 dhjetor 2017)*. Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës.
- Burckhardt, T. 2012. *Arti i Islamit*. Përkth. V. Kola. Tiranë: Logos-A.
- Ibrahimi, N. (Përkth.). 2000. *Si ta njohim artin islam*. Prishtinë: Dituria Islame.
- Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës. 1992. *Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët: Simpozium ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë më 15–17 tetor 1992*. Prishtinë.
- Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës. 2003. *Shtypi islam dje, sot dhe nesër: Përmbledhje kumtesash nga konferenca shkencore (Prishtinë, 23–24 maj 2003)*. Prishtinë.
- Pirraku, M. 1971. *Historia e letërsisë shqiptare* (Vol. I–II). Prishtinë.

Revista

- Periodiku *Takvimi*. Numrat e konsultuar: 1–28. Revista *Dituria Islame*. Numrat e konsultuar: 1–114.
- Revista *Edukata Islame*. Numrat e konsultuar: 1–64.

Faqe interneti

www.bislame.net

www.islamgjakova.net